



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**  
**Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture**  
**Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

<b>DATË/A:</b>	19/04/2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis Komuna Junik
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Servet Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shqyrtimi i shkresës nga Komuna e Junikut me numër të protokollit 2053/23 të datës 18/04/2023 për dhënie të pëlqimit për Taksat e lejes ndërtimore

Të nderuar/a,

Bazuar në shkresën e datës 18/04/2023 me numër protokollit 2053/23, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe taksës administrative për leje rrënimi nga Komuna e Junikut (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën së bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë e llogaritur nga Komuna është **1.49 €/m<sup>2</sup>** (një euro e katër dhjetë e nëntë cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të e llogaritur nga Komuna është **2.68 €/m<sup>2</sup>** (dy euro e gjashtëdhjetë e tetë cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi e llogaritur nga Komuna për kategorinë I dhe II është **0.92 €/m<sup>2</sup>** ( zero euro e nëntëdhjetë e dy centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1